



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
 VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Në ankesën e :

AC-I-17-0675

Q. M Malishevë.

Paditësi/Ankuesi

përfaqësuar nga **Av. B I**, Prishtinë.

Kundër:

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Agim Ramadani” nr.23, Prishtinë.

E paditura

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtarë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-IV-14-3706 të datës 08 nëntor 2017, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 21/07/ 2020, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.

2. Vërtetohet, Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar i DHPGJS-së, C-IV-14-3706 i datës 08 nëntor 2017.
3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 27 janar 2014, paditësi Q. M dhe ish punëtorët tjerë të N “M” të përfaqësuar nga Av B. I e kanë dorëzuar në DHPGJS një ankesë të përbashkët kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së PRZ008-1549 të datës 23.12.2013 me të cilin kërkesa e paditësit për kompensim të pagave për periudhën 23 mars 1992 - 30 qershor 1999 në shumë prej 4.386,00 euro, ishte refuzuar pasi që kërkesa është vlerësuar se është parashkruar. Ankesa e përbashkët e datës 27.01.2014, ishte ndarë në lëndë të veçanta dhe ankesa e paditësit ishte reregjistruar me datë 25.04.2014, me numër C-IV-14-3706.

Me datë 08 nëntor 2017, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-3706 ankesën e paditësit e refuzon si të pabazuar dhe e vërteton vendimin e ankimit të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Kolegji i Specializuar ka arsyetuar se ankesa e dorëzuar në DHPGJS kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit nuk është parashtruar me vonesë siç pretendon e paditura, pasi që ndryshimet teknike si ndarja e ankesës në dy lëndë të veçanta, ri regjistrimi dhe numri regjistruar i ri i lëndës i përgatitur nga gjykata nuk janë arsye të cilat parandalojnë ankuesin që të shfrytëzojnë të drejtën e tij ligjore për të paraqitur ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit. Andaj ankesa është e pranueshme. Kolegji i Specializuar lidhur me meritat e ankesës ka konstatuar se parashkrimi i kërkesës është rregulluar me dispozitat e LMD-së, dhe kërkesa e paditësit për paga për periudhën 1992-1999 ishte rregulluar me dispozitat e LMD-së të vitit 1978, i cili ende është në fuqi dhe ky ligj e ka mbajtur afatin e parashkrimit prej 3 vitesh. Tutje Kolegji i Specializuar ka arsyetuar se vendimi i pakontestuar i Këshillit të Punëtorëve i datës 11.08.2005, i cili miratoi të drejtën e paditësit për pagat e papaguara në shumë prej 4.386,00 euro ka ndërprerë parashkrimin dhe afati i ri i parashkrimit ka përfunduar me 11 gusht 2008, andaj kërkesa për paga të papaguara është e parashkruar. Kolegji i Specializuar arsyeton se njoftimi i dërguar nga AKP-ja për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me datë 06.11.2009, nuk e ka ndërprerë parashkrimin pasi që në datën e

pranimi të këtij njoftimi, kërkesa veçse ishte parashkruar. Ky njoftim do të kishte pasur efekt të njohjes së borxhit nga debitori po të ishte pranuar ajo para afatit të parashkrimit, me datë 11.08.2008.

Me datë 21 nëntor 2017, paditësi (në tekstin e mëtejme ankuesi) ka parashtruar një ankesë të afatshme kundër Aktgjyqimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së C-IV-14-3706 të datës 08 nëntor 2017, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa si e bazuar të anulohet Aktgjykimi i ankimuar i Kolegjit të Specializuar dhe rasti të kthehet në rivendosje si dhe të detyrohet e paditura që të kompensoj ankuesin në përputhje me tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës.

Për më tepër në ankesë ankuesi pohon se gjykata e Shkallës së parë nuk ka konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, pasi në rastin konkret kemi pohim të detyrime dhe zotim për ti paguar detyrimet në të ardhmen nga ana e NSH-së. Tutje ankuesi pretendon se me datë 06.11.2009 ishte ndërprerë parashkrimi i kërkesës pasi që në njoftimin e dërguar për ndërprerje të marrëdhënies së punës ishte pohuar se kërkesat do të shqyrtohen në procedurën e likuidimit. Ankuesi në ankesë pretendon se dita se kur ka rrjedhë afati i parashkrimit është momenti kur është hapur procedura e likuidimit të NSH-së, andaj në rastin konkret nuk mund të bëhet fjalë për parashkrim të kërkesës.

Tutje ankuesi në ankesë pohon se konstatimi i gjykatës se njoftimi i AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës nuk ka pasur efektin e rifillimit të parashkrimit është interpretim i gabuar i së drejtës materiale, ngase pohimi qoftë direkt apo indirekt në mënyrë automatike e rifillon afatin e parashkrimit edhe nëse pohimi bëhet pas skadimit të afatit të parashkrimit dhe kjo parashihet në nenin 392.2 të LMD-së.

Në përgjigjen e vetë të datës 06/07/2020, AKP-ja kërkoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetoi Aktgjykimin e ankimuar.

Arsvetimi ligjor:

Ankesa e paditësit refuzohet si pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Kolegjit të Specializuar është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor andaj duhet të vërtetohet.

Paditësi me padinë e tij të përbashkët të dorëzuar në DHPGJS me datë 27 janar 2014, dhe të reregjistruar me datë 25 prill 2014, ka kërkuar të anulohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së PRZ008-0546 të datës 23.12.2013, me të cilin kërkesa e paditësit për kompensim e pagave për periudhën 23 mars 1992 - 30 qershor 1999 në shumë prej 4.386,00 euro, ishte refuzuar si e pa bazuar, pasi që Autoriteti i Likuidimit ka vlerësuar se kërkesa për këto paga ishte parashkruar.

Kolegji i Apelit vëren se në këtë periudhë kohore ligj i zbatueshëm në Kosovë në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24, ishte Ligji i Punës së Bashkuar. Sipas nenit 608 të këtij ligji kërkesat për paga parashkruhen në periudhën prej 3 vite. Ngjashëm këtë afate kohor të parashkrimit e ka paraparë edhe neni 372 paragrafi 1 i LMD-së i vitit 1987, në të cilin ligj Kolegji i Specializuar e ka bazuar refuzimin e ankesës së paditësit.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se paditësi kërkesën për paga e ka dorëzuar në NSH vetëm me datë 09 gusht 2013, ndërsa në gjykatë me datë 27 janar 2014, që është tashmë tepër vonë. Andaj kërkesa për këto paga për periudhat e cekura tashmë ishte parashkruar.

Kolegji i Apelit e pranon konstatimin e Kolegjit të Specializuar se megjithatë në këtë rast një herë kishte ndërprerje të parashkrimit, kur me vendimin e Këshillit të punëtorëve të NSH-së të datës 11 gusht 2005, ishte pranuar borxhi për pagat e pa paguara për periudhën e cekur në

shumë prej 4.386,00 euro, mirëpo afati tjetër i parashkrimit ka rrjedhë dhe parashkrimi ka ndodhë me 11 gusht 2008, pasi që kishte kaluar afati prej tri vite i parashkrimit.

Është po ashtu i drejtë konstatimi i Kolegjit të Specializuar se njoftimi i AKP-së për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me datë 06 nëntor 2009, që i ishte dërguar paditësit në nëntor 2009, nuk e kishte ndërprerë afatin e parashkrimit, pasi që parashkrimi i kërkesës tashmë veçse kishte ndodhur.

Njoftimi i AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës, do të kishte pas efektin e njohjes së borxhit nga debitori po të ishte pranuar ma herët, para afatit të parashkrimit, i cili kishte ndodhë me datë 11 gusht 2008.

Prandaj nga arsyet e cekura ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore në shumë prej 20 euro me datë 26.03.2018, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 21/07/2020.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar kryesues
